

Nr. 0595/17
Data 13.03.2017
PRISHTINE



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIIZJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

RREGULLORE

PËR

KOMPENSIM/SHPËRBLIM

PËR TË PUNËSUARIT NË

RADIOTELEVISIONIN E KOSOVËS

Në bazë të Ligjit të RTK-së, neni 29, pika 2.2 dhe të Statutit të RTK-së, nenit 36, pika 11 dhe legjislacionit në fuqi Bordi i RTK-së miraton këtë:

RREGULLORE PËR KOMPENSIM/SHPËRBLIM PËR TË PUNËSUARIT NË RADIOTELEVISIONIN E KOSOVËS

Neni 1 QËLLIMI

Me këtë rregullore përcaktohet lartësia e mjeteve për kompensim, shpërblim të të punësuarve në RTK, bazat dhe kushtet për kompensimin dhe shpërblimin e të punësuarve dhe kryerjes së punëve të cilat nuk janë të parapara me kontratë të punës.

Neni 2 FUSHËVEPRIMI

Kjo rregullore vlen për të gjithë të punësuarit, të cilët janë punëtorë të rregullt në RTK.

Neni 3 PËRKUFIZIMET

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

1. **Shpërblim:** Të hollat që i jepen punëtorit të rregullt të RTK-së, për arritje të larta ose për suksese të mëdha në punë.
2. **Kompensim:** Të hollat që i jepen punëtorit të rregullt të RTK-së për punë shtesë, të cilat nuk janë në përshkrimin e tij të punës.

Neni 4 MJETET PËR KOMPENSIME/SHPËRBLIME

Mjetet për kompensimin/shpërblimin e të punësuarve, sipas kësaj rregulloreje, përcaktohen me planin vjetor dhe projeksionin buxhetor të RTK-së të miratuar paraprakisht në Bordin e RTK-së.

Neni 5 KOMPENSIMI/SHPËRBLIMI NË PUNË

Përcaktimi i kompensimit/shpërblimit të të punësuarve bazohet në vëllimin e punëve të kryera, cilësinë e punëve të kryera dhe angazhimin shtesë të deleguar nga eprori i drejtpërdrejtë.

Neni 6

SHUMA E MJETEVE TË KOMPENSIMIT/SHPËRBLIMIT

Shuma e mjeteve të kompensimit/shpërblimit të punëtorëve propozohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, ndërsa lartësinë e kompensimit/shpërblimit e përcakton udhëheqësi i njësisë. Kompensimi/shpërblimi maksimal mujor nuk mund të tejkalojë 30 % të pagës bazë të të punësuarit.

Neni 7

VERIFIKIMI I PROPOZIMIT

Lartësinë e kompensimit/shpërblimit e verifikon dhe e miraton Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së, në bazë të propozimit apo iniciativës së Drejtorit të Radios dhe të Televizionit dhe Udhëheqësit të shërbimeve të përbashkëta.

Neni 8

PUNËTORËT ME AUTORIZIME TË VEÇANTA

1. Kompensimi, shpërblimi i të punësuarve me autorizime dhe përgjegjësi të veçanta bëhet një herë në vit, në lartësi prej më së shumti 1 pagë të të punësuarit.
 - 1.1 Shkalla e realizimit të planit programor-produksional
 - 1.2 Cilësia programore-produksionale
 - 1.3 Reagimi publik si rritja e shikueshmërisë, dëgjueshmërisë
 - 1.4 Realizimi i projekteve zhvillimore
 - 1.5 Cilësia e lartë e shërbimeve profesionale
 - 1.6 Shfrytëzimi racional i resurseve njerëzore dhe tekniko-operative

Neni 9

SHTESAT FIKSE

1. Me propozimin me shkrim të eprorit të drejtpërdrejtë, Drejtori i Përgjithshëm, për angazhim shtesë, të punësuarit mund t'i aprovojë kompensim për periudhë të caktuar, në lartësi më së shumti deri në dy (2) koeficiente.
2. Këtë shtesë mund ta marrin të punësuarit, të cilët kanë arritur suksese të mëdha në punë për një periudhë më të gjatë kohore, kanë reagime pozitive programore në publik, siç janë yjet mediale ose personat që janë fitues të çmimeve ndërkombëtare, kanë udhëhequr me sukses ekipet projektuese-produksionale, kanë dhënë propozime me vlerë, që janë dëshmuar në praktikë, kanë autorizime të veçanta për kryerjen e proceseve specifike të punës me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm.
3. Kjo duhet të arsyetohet në detaje në propozimin me shkrim. Shtesa me angazhim shtesë mbi punësimin përfundon në atë moment kur pushon së ekzistuari nevoja për pagesën e atyre të punësuarve për kryerjen e detyrave konkrete të përcaktuara me angazhim shtesë.

Neni 10

FORMAT E KOMPENSIMIT/SHPËRBLIMIT SHITESË

1. Të punësuarit, i cili në periudhën e caktuar, pos që i kryen punët e veta, i kryen edhe ato të të punësuarit që mungon, i përkasin të ardhurat shtesë.
2. Nëse një i punësuar i kryen edhe detyrat e punëtorit që mungon, i përkasin të ardhurat shtesë në lartësi prej 30% në të ardhurat bazë të punëtorit të cilin e zëvendëson.
3. Nëse dy të punësuar i kryejnë edhe detyrat e punëtorit që mungon, atyre u përkasin të ardhurat shtesë në lartësi prej 15% në të ardhurat bazë të punëtorit që e zëvendësojnë.
4. Kompensimi/Shpërblimi i të punësuarit mund të bëhet më së shumti për një vit. Ky kompensim/shpërblim përjashton pagesën për punë jashtë orarit të rregullt të punës.

NENI 11 MBIKËQYRJA

Për vendimet për kompensime/shpërblime dhe angazhim shtesë, Bordi i Drejtorëve njoftohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 12 HYRJA NË FUQI

Kjo Rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas nënshkrimit të saj.

Kryetari i Bordit të RTK-së

Ismet Bexheti

